


Qendra e Botimeve për Diasporën boton libra dygjuhësh në ndihmë të fëmijëve të diasporës



Përrallat më të bukura klasike për fëmijë do të jenë në duart e fëmijëve të diasporës në një format ndryshe dhe mjaft interesant. Qendra e Botimeve për Diasporën, në një projekt ambicioz e mjaft të vlefshëm kushtuar përhapjes së gjuhës shqipe në Diasporë, sjell libra dygjuhësh në shqip e italisht, shqip e greqisht, shqip e anglisht etj. Librat e përzgjedhur me kujdes, janë me ilustrime të bukura e tërheqëse, me një shqipërim mjeshtëror dhe të përshtatur për fëmijët e grupmoshës 5-8 vjeç. "Hirushja" dhe "Pinoku" janë përrallat e para të kolanës me katëmbëdhjetë përralla në proces botimi. Një mënyrë shumë tërheqëse për pasurimin e fjalorit dhe të shprehive në gjuhën shqipe të fëmijët, që nxit edhe më tepër tek ata interesin dhe dashurinë për gjuhën shqipe.

Aplikacioni informues "Diaspora Shqiptare"



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

Parlamenti grek, ligj për punëtorët sezonalë shqiptarë



Zgjidhja e çështjes së punëtorëve sezonalë nga Shqipëria, që perbejnë rreth 90% të numrit të punëtorëve në sektorin grek të bujqësisë, është kthyer në kryefjalë në Parlamentin Grek. Sipas Ministrisë të Zhvillimit Rural në Greqi, Makis Voritis, ky është një prioritet i cili do të marrë zgjidhje këtë javë me miratimin e një projekti ligji mbi masat mbrojtëse dhe kontrollet që punëtorët do të duhet të kalojnë për t'u rikthyer sa më shpejt punës në Greqi. "Brenda javës do të dorëzojmë një ligj në Parlament në mënyrë që çështja e fermerëve sezonalë nga Shqipëria që punojnë në Greqi, të marrë një zgjidhje. Me garanci shëndetësore do të kemi numrin e punëtorëve që na duhen, në mënyrë që të mos ketë ndonjë çrregullim, sidomos për produktet e prodhuara në maj dhe qershor si qershia dhe pjeshka", deklaroi Voritis. Ministri është shprehur në mediat greke për këtë çështje që në 22 prill.

Aplikacioni gazeta "Diaspora Shqiptare"



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

KKD / Mark Gjonaj, pjesë e nismave për ndihmë në komunitet



Mark Gjonaj, kryetar i Këshillit Koordinues të Diasporës dhe njëkohësisht këshilltar i Bashkisë së Nju Jork-ut, u është bashkuar nismave solidare për t'i ardhur në ndihmë komuniteti në këto ditë të vështira. Së bashku me organizatat humanitare shqiptaro - amerikane kanë shpërndarë ndihma për qytetarët në nevojë në Bronx të SHBA-së. Gjonaj shprehu falenderim për të gjithë ata të cilët iu bashkuan kësaj nisme: "Askush nuk mund t'i ndihmojë të gjithë, por të gjithë mund ta ndihmojnë dikë. Ne jemi në gjithë këtu së bashku!".


"Raporto" problemin në çdo kohë në Ambasadalme



App store [këtu](#): Play store [këtu](#):

KKD / Brikena Muharremi takim online me studentët shqiptarë

Avokatja shqiptare Brikena Muharremi, anëtare e Këshillit Koordinues të Diasporës, zhvilloi një takim online me studentët e Fakultetit Juridik të Universitetit të Mitrovicës për të diskutuar mbi temën "Legjislacioni për menaxhimin e pandemisë COVID-19 në Britaninë e Madhe". Muharremi është e licensuar në Londër si avokate me të drejta përfaqësimi në të gjitha gjykatat në Angli dhe Uells. Ajo, gjithashtu, është themeluese dhe kryetare e Shoqatës së Avokatëve Shqiptaro-Britanik në Mbretërinë e Bashkuar (BALA) që nga viti 2016.



KKD / Gazmend Kapllani vlerëson nismën e grave shqiptare



Lidhja e Gruas Shqiptare në Greqi synon promovimin e vlerave dhe traditave shqiptare brenda bashkësisë shqiptare në Greqi. Gjatë ditëve të vështira të pandemisë shoqata i është përkushtuar përkujdesjes së emigrantëve shqiptarë atje, duke u bërë ndihmë për ta dhe shembull humanizmi e patriotizmi për gjithë diasporën shqiptare. Autori dhe njëkohësisht anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës Gazmend Kapllani vlerëson një prej anëtarëve të kësaj lidhjeje si një model pozitiviteti e bujarie.

KKD / Lazim Destani dhuron ndihma për fëmijët në nevojë



Lazim Destani, anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës dhe njëkohësisht President Nderi i Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare, dhuron pajisje elektronike për t'u mundësuar ndjekjen e mësimin onlin nxënësve në Maqedoninë e Veriut.